



RAPORT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE BAZUAR NË KORNIZËN E MONITORIMIT TË KOMUNAVE



Funded by
the European Union



Raport për të Drejtat e Fëmijëve bazuar në Kornizën e Monitorimit të Komunave

Autorë:

Ljubiša Baščarević - Konsulent i jashtëm
Ekipi i Domovik-ut

Ekipi i Domovik-ut:

Domovik
Sutjeska p.n Mitrovica e Veriut
E-mail: office@domovik.org
www.domovik.org



PUBLIKUAR: 2023

Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Domovik dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. INFORMATA RRETH ZHVILLIMEVE TË MËHERSHME	5
3. METODOLOGJIA	6
4. TË GJETURAT E MONITORIMIT	8
4.1. SHËNDETI DHE TË USHQYERIT	8
4.1.1 Të ushqyerit.....	8
4.1.2 Imunizimi	9
4.1.3 Shëndeti i nënës, të porsalindurit dhe fëmijës.....	10
4.1.4 Sistemi shëndetësor	11
4.1.5 Shëndeti fizik, mendor dhe riprodhues i adoleshentëve.....	12
4.2 MJEDISI DHE MBROJTJA FAMILJARE.....	13
4.2.1 Dhuna ndaj fëmijëve dhe grave	13
4.2.2 Fëmijët pa kujdes prindëror.....	14
4.2.3 Drejtësia për fëmijët	14
4.2.4 Martesa e fëmijëve dhe praktika të tjera të dëmshme.....	15
4.2.5 Shfrytëzimi i fëmijëve.....	16
4.3 ARSIMI	17
4.3.1 Sistemi i arsimit	17
4.3.2 Qasja dhe pjesëmarrja në shkollim	18
4.3.3 Aftësitë dhe cilësitë e të nxënësve	19
4.3.4 Koha e lirë dhe kultura	19
4.4 PJESËMARRJA DHE TË DREJTAT CIVILE.....	20
4.4.1 Regjistrimi i lindjes dhe identiteti	20
4.4.2 Pjesëmarrja e fëmijëve	21
4.4.3 Liritë dhe politikat civile	21
4.4.4 Të dhënat, interneti dhe mbrojtja e privatësisë.....	22
4.5 VARFËRIA	22
4.5.1 Sistemi i mbrojtjes sociale.....	23
4.5.2 Varfëria e fëmijëve dhe privimi material	23
4.5.3 Uji, kushtet sanitare dhe higjiena	24
5. ÇËSHTJET NDËRSEKTORIALE	25
5.1 SHKOLLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME.....	25
5.2 GJINIA	25
5.3 AFTËSIA E KUFIZUAR	25
5.4 ADOLESHENTËT.....	26
5.5 MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	26
5.6 RREZIQET DHE VEPRIMET HUMANITARE	26
6. PËRFUNDIME.....	27

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është përpiluar duke iu referuar Kornizës për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve në Komuna, të cilën OJQ Domovik e ka zhvilluar në 2022/2023. I referohet komunave Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, me disa të dhëna të ndërlidhura për Mitrovicën e Veriut, e cila është një qendër rajonale për shërbimet shëndetësore, arsimore dhe të mbrojtjes sociale, të mbështetura nga qeveria serbe për të katër komunat. Mjeti i monitorimit përmban një sërë treguesish të kontekstualizuar për nivelin lokal, duke mbuluar 5 fusha përkatëse për të drejtat e fëmijëve bazuar në Kornizën e Monitorimit të UNICEF për Evropë Qendrore dhe Azi (ECA). Këto fusha përfshijnë shëndetin ushqyerjen, mjedisin dhe mbrojtjen familjare, arsimin, pjesëmarrjen dhe të drejtat civile dhe varfërinë. Secila fushë përbëhet nga disa nënfusha, me grup treguesish përkatës të përcaktuar për vlerësimin e situatës në secilën fushë specifike. Gjithsej, janë mbledhur të dhëna për 85 tregues të vendosur për nënfushat përkatëse të të 5 fushave kryesore.

Sfida kryesore për raportim mbetet qasja në të dhëna dhe informacione të sistemuara në sektorë të veçantë të të drejtave të fëmijëve, kryesisht për shkak të praktikës së pazhvilluar institucionale në menaxhimin e të dhënave dhe njohurive. Prandaj, ky raport kryesisht mbështetet në vëzhgimet, vlerësimet dhe intervistat me palët e interesit. Megjithatë, përkundër të gjitha sfidave në mbledhjen e të dhënave, raporti ofron nivel të mjaftueshëm të saktësisë së informacionit të shfrytëzuar për nxjerrjen e përfundimeve mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve në komunat e përfshira në vlerësim. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet nga ky raport mund të shërbejnë si një bazë e mirë për raportet e ardhshme të monitorimit duke iu referuar kësaj kornize.

Në fushën shëndeti dhe ushqyerja, fëmijët kanë qasje të mirë në shërbimet bazë në kujdesin shëndetësor parësor dhe pjesërisht atë sekondar, ndërsa shërbimet e kujdesit shëndetësor terciar nga këto komuna përdoren kryesisht në qendrat klinike në Serbi. Qasja në imunizim i jepet çdo fëmije, por ndërgjegjësimi i prindërve është i nevojshëm për vaksinat HPV dhe MMR, për shkak të pjesëmarrjes së ulët të fëmijëve në ciklet përkatëse të vaksinimit, shkaktuar nga qëndrimet negative ndaj vaksinimit dhe keqinformimi që qarkullon në publik. Përqindja e ulët e foshnjave dhe fëmijëve që ushqehen me gji kërkojnë përpjekje të përforcuara në promovimin dhe ndërgjegjësimin e nënave për përfitimet e mëdha që gjidhënia sjell për shëndetin e fëmijës dhe nënës.

Në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes familjare, dhuna ndaj grave dhe fëmijëve mbetet një nga shqetësimet më serioze në të gjitha komunat e përfshira si dhe në komunat tjera në Kosovë. Mosekzistenca e shërbimeve të mbrojtjes dhe riintegritit dhe mungesa e programeve dhe veprimeve efektive parandaluese rezultojnë me raportim të pamjaftueshëm të rasteve, duke i lënë gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës në familje pa qasje në drejtësi dhe në shumë raste duke kontribuar në mbetjen e tyre brenda rrethit vicioz të dhunës dhe diskriminimit. Rritja e shërbimeve alternative të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në komunitet duhet të çojë drejt ndryshimit të praktikës së vendosjes së fëmijëve në kujdestari me familjet në Serbi, gjë që zvogëlon mundësitë për ribashkim të mundshëm me familjet e tyre biologjike. Në fushën

e drejtësisë për fëmijët nuk ka programe për parandalimin e delikuencës së të miturve, apo shërbime përkujdesjeje për të miturit e liruar nga paraburgimi. Mungesa e shërbimeve të riintegritit për fëmijët në konflikt me ligjin shoqërohet me bashkëpunim të pamjaftueshëm ndërmjet shërbimit korrektues, shërbimit sprovues dhe qendrave lokale të mirëqenies sociale, si dhe burime të pazhvilluara për aplikimin e sanksioneve alternative dhe masave diversionale në nivel vendor. Dhomat dhe hapësirat miqësore të intervistimit të fëmijëve në gjykata dhe qendra për mirëqenien sociale duhet të riaktivizohen ndërsa në vendet ku mungojnë të bëhet vendosja e tyre. Nuk ka veprime afirmative për mbrojtjen e fëmijëve nga puna e detyruar, shfrytëzimi seksual komercial dhe abuzimi seksual në internet.

Në fushën e arsimit, qasja e fëmijëve në programet dhe objektet e shkollimit në fëmijërinë e hershme mbetet sfidë në zonat rurale të të tri komunave ndërkohë që cilësia e arsimit të ofruar në nivelin fillor dhe të mesëm duhet të përmirësohet përmes avancimit të mëtejshëm të metodologjive të mësimdhënies dhe ngritjes së kapaciteteve të mësuesve. Rezultatet e testimeve më të fundit PISA duhet të merren seriozisht në konsideratë dhe të rezultojnë me veprime konkrete për adresimin e sfidave dhe mangësive që çojnë drejt rezultateve të pakënaqshme të të nxënit të nxënësve të shkollës. Përmirësimi i qasjes dhe diversifikimi i mundësive për arsimin joformal do të ketë efekt stimulues në këto përpjekje.

Në fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të drejtave civile, duhet të bëhen përpjekje që zëri i fëmijëve të dëgjohet më mirë në planifikimin dhe zbatimin e politikave lokale, veçanërisht për politikën dhe programet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fëmijët dhe mirëqenien e tyre. Pjesëmarrja e tyre në organet vendimmarrëse në arsim duhet të kalojë nga përfaqësimi formal në anëtarësimin aktiv dhe ndikim në proceset vendimmarrëse dhe rezultatet e tyre. Procedurat miqësore të ankimit për fëmijët dhe mekanizmat e reagimit që kanë cak fëmijët duhet të vendosen tek të gjithë ofruesit e shërbimeve për fëmijë. Nuk duhet të ketë kufizime në dhënien e së drejtës për t'u dëgjuar për shkak të moshës, paaftësisë ose ndonjë cenueshmërie tjetër. Pjesëmarrja e tyre duhet të sigurohet në të gjitha procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, kujdesit dhe birësimit të fëmijëve, çështjeve shëndetësore, proceseve familjare dhe vendimmarrjes në familje.

Në fushën e varfërisë, raporti ripohon rolin kritik të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe thekson nevojën për qasjen e tyre më proaktive dhe shtrirjen e tyre më të gjerë sa u përket familjeve më të cenueshme që kanë fëmijë. Në komunat e pazhvilluara në aspektin social dhe ekonomik, me mundësi të kufizuara punësimi, skema e asistencës sociale është burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave për këto familje. Kjo ndihmë duhet të jetë e shtrirë tek të gjitha familjet dhe fëmijët në nevojë dhe duhet të ngritet për t'iu përgjigjur më mirë krizave të fundit ekonomike që prekin në mënyrë disproporcionale popullsinë më të cenueshme. Programi i mbështetjes ushqimore i ndihmuar nga Kryqi i Kuq njihet si një praktikë e mirë, megjithatë përbindja e lartë e familjeve dhe fëmijëve që jetojnë në varfëri relative dhe absolute ngre shqetësime për kequshqyerjen dhe përkeqësimin e kushteve të tjera për zhvillimin psikofizik të fëmijëve.

2. Informata rreth zhvillimeve të mëhershme

Çdo raport i të drejtave të njeriut i cili bazohet në tregues cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e llogaridhënies së bartësve të detyrës në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, varet kryesisht nga qasja në të dhëna të qëndrueshme për performancën dhe rezultatet e tyre. Sa u përket komunave që mbulohen në këtë raport, përtej faktorëve të tjerë subjektivë, procesi i mbledhjes së të dhënave është ndikuar shumë me situatën më të fundit politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës. Një sërë zhvillimesh të ndërlidhura me njëra tjetrën pothuajse paralizuan funksionimin institucional në këtë zonë dhe krijuan pengesa serioze për mbledhjen e të dhënave, krahas kulturës institucionale tashmë inekzistente në këtë fushë. Në të katër komunat u krijua një vakum i përkohshëm institucional i cili zgjati deri në organizimin e zgjedhjeve lokale në prill 2023. Përkundër se u bojkotuan nga shumica dërrmuese e komuniteteve lokale në Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë të Veriut, autoritetet e sapozgjedhura komunale morën përsipër detyrat dhe deklaruan disponueshmërinë për ofrimin e shërbimeve për të gjithë banorët. Megjithatë, ata nuk kanë staf të plotë dhe të pajisur me të gjitha burimet e nevojshme teknike dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve.

3. Metodologjia

Metodologjia për zhvillimin e këtij raporti monitorues është përshkruar në detaje në publikimin e Domovik-it, Korniza e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve në Komuna. Ai bazohet në mbledhjen e të dhënave mbi treguesit strukturorë, të procesit dhe të rezultateve të kontekstualizuar për nivel lokal duke iu referuar standardeve dhe praktikës ndërkombëtare, të përfshira në Treguesit e të Drejtave të Njeriut, publikuar nga OHCHR.

Çështjet lidhur me mbledhjen e të dhënave janë përshkruar tashmë në përmbledhjen e politikave “Ngritja e politikave lokale të bazuara në dëshmi për fëmijët”¹ përgatitur nga Domovik në vitin 2020, që zbuloi se në fushën e kujdesit shëndetësor, nuk ka të dhëna në dispozicion të cilat janë të sistemuara dhe të përditësuara rregullisht lidhur me zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të fëmijës. Është relevante për të dhënat për shkallën e vdekshmërisë neonatale, shkallën e vdekshmërisë foshnjore dhe atë nën 5 vjeç, fëmijët e mbuluar me vaksinim, përdorimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe shtrimin në spital të fëmijëve gjatë vitit (të ndara sipas statusit socio-ekonomik dhe zonës së banimit). Për këtë raport, disa të dhëna janë marrë nëpërmjet komunikimit dypalësh me stafin e qendrës së mjekësisë familjare. Përmbledhja e politikave të sipërpërmendura gjithashtu identifikoi mungesën e të dhënave të sistemuara në të gjitha komunat për aspekte të ndryshme të mbrojtjes sociale, duke theksuar mungesën e të dhënave për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e mbrojtjes sociale në komunitet ose numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin shërbimet mbështetëse në shtëpi, tek të afërmit, institucione kujdestare ose familje kujdestare. E njëjta gjë vlen edhe për mosekzistencën e të dhënave të kategorizuara për numrin e fëmijëve të abuzuar dhe të neglizhuar, të regjistruar në qendrat për punë sociale.

Një nga mundësitë për mbledhjen e të dhënave në të ardhmen në kategorinë Shëndeti dhe të ushqyerit janë planet e reja 3-vjeçare të veprimit të zhvilluara nga qendrat e mjekësisë familjare në Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq (2022-2024) të cilat parashikojnë investime në zhvillimin e bazave elektronike të të dhënave për shëndetin e nënës dhe fëmijës, trajnimin e stafit për përdorimin e tyre dhe mbajtjen e të dhënave dhe regjistrave. Në këtë drejtim, fushat specifike të ndërhyrjes përfshijnë imunizimin dhe infermierinë në komunitet. Kjo duhet të mbështesë procesin e mbledhjes së të dhënave të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, që pritet të themelohet në komunat e synuara. Pavarësisht disa përparimeve të vërejtura në kuadrin e planifikimit të politikave për mbledhjen e të dhënave, zbatimin e tyre praktik ende nuk është integruar si metodë pune në praktikën e akterëve kryesorë institucionalë.

Në rrethana të tilla, mbledhja e të dhënave për këtë vlerësim u organizua duke kombinuar metoda cilësore dhe sasore duke përfshirë anketat dhe intervistat e strukturuar, intervistat gjysmë të strukturuar dhe të pastrukturuar me palët kryesore të interesit dhe përfituesit në dispozicion, takimet e fokus grupeve me profesionistë të sektorit, vëzhgimet dhe analizat në zyrë. Takimet e grupit të fokusit shërbyen për verifikimin alternativ dhe vërtetimin e të dhënave të marra përmes metodave të tjera të mbledhjes së të dhënave.

¹ https://domovik.org/wp-content/uploads/2022/01/Policy-Paper_-_Unapredjenje-lokalnih-politika-za-decu_2020_compressed.pdf

Ekipi i projektit identifikoi të gjitha burimet përkatëse për mbledhjen e të dhënave dhe zhvilloi pyetësorë specifikë për sektorin, megjithatë, nuk ishte e mundur të merreshin të dhënat më të sakta për shkak të padisponueshmërisë së tyre ose pamundësisë së burimeve të të dhënave për të ofruar informacion të saktë, kryesisht për shkak të mbledhjes dhe ruajtjes jo të sistematizuar të të dhënave në institucionet përkatëse. Në këtë situatë, ekipi i projektit ka bërë përpjekje maksimale për të ofruar vlerësimet sa më të sakta. Referencat ndaj të dhënave MICS nga viti 2020 shërbejnë si një lloj bazë për të vlerësuar gjendjen e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal, edhe pse anketa MICS mori të dhëna duke përdorur metodat e kampionimit dhe madhësinë për nivel kombëtar. Krahasimi i të dhënave MICS është bërë me të dhënat e disponueshme nga dy Raportet e Grumbullimit të të Dhënave të përgatitura nga Domovik në vitin 2021² dhe 2022³, dhe grupet e të dhënave të disponueshme me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhe vlerësimet sektoriale të bëra nga UNICEF, UNFPA, ONP dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

² <https://domovik.org/wp-content/uploads/2022/12/Polozaj-dece-na-teritoriji-3-opstine-severnog-dela-Kosova.pdf>

³ https://domovik.org/wp-content/uploads/2023/05/Data-collection-report_2022.pdf

4. Të gjeturat e monitorimit

Në këtë kapitull, analizat janë bërë për të 5 fushat e të drejtave të fëmijëve dhe nënfushat e tyre përkatëse, bazuar në të dhënat e disponueshme për treguesit e vendosur dhe mbledhur nëpërmjet burimeve të specifikuar në mjetin e zhvilluar nga Domovik. Për këtë raport të parë, gjetjet do të bazohen kryesisht në aspekte cilësore të vlerësuara në bazë të vëzhgimeve, intervistave gjysmë të strukturuar dhe të pastrukturuar, duke qenë se qasja në informacionin statistikor ishte jashtëzakonisht e kufizuar. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha pengesat në mbledhjen e të dhënave, vlerësimi ofron njohuri shumë të rëndësishme për gjendjen e shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve dhe shpresojmë të shërbejë si një referencë e vlefshme për të gjitha palët e interesit të drejtave të fëmijës në përpjekjet e tyre të ardhshme për të përmirësuar cilësinë e jetës së fëmijëve dhe prindërve të tyre.

4.1. Shëndeti dhe të ushqyerit

Nën domenin shëndeti dhe të ushqyerit, janë përcaktuar 5 nënfusha duke përfshirë të ushqyerit, imunizimin, shëndetin e nënës, të porsalindurve dhe atë riprodhues, sistemin shëndetësor dhe shëndetin fizik, mendor dhe riprodhues të adoleshentëve. Të dhënat komplekse nën çdo nënfushë duhet të krijohen dhe mirëmbahen ende nga palët institucionale të interesit për të mbështetur vlerësimet e ardhshme të bazuara në dëshmi në sektorin e shëndetësisë.

4.1.1 Të ushqyerit

Ushqyerja e duhur është një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të fëmijës, ndërsa marrja e sasive të mjaftueshme të lëndëve ushqyese kyçe ndikon në rritjen dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës. Në përputhje me standardet e OBSH-së, është bërë vlerësimi i *përqindjes treguese të fëmijëve nëneshë 0-5 vjeç (duke marrë parasysh devijimin nga peshë mesatare e fëmijëve të moshës përkatëse)*. Duke pasur parasysh që të dhënat për peshën e fëmijëve nuk mbledhen dhe ruhen sistematikisht në asnjë nga komunat e synuara, referenca bëhet bazuar në të dhënat e MICS për Kosovën, të marra në vitin 2020. Ky anketim i MICS gjeti se 5% e fëmijëve nga 0-5 vjeç vlerësohen me deficit kronik të ushqyerjes së duhur, 2% me mungesë akute të ushqyerjes, 2% u vlerësuan nëneshë dhe 2% mbipeshë. Bazuar në të dhënat e Qendrës Shëndetësore në Mitrovicën e Veriut, vlerësimi është se përqindja e fëmijëve me deficit kronik të peshës, mungesë akute të ushqyerjes, nëneshë dhe mbipeshë në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit në moshën 0-5 vjeçare korrespondojnë me të dhënat në mbarë Kosovën të marra përmes MICS.

Ushqyerja me gji është praktikë shumë e rëndësishme e ushqyerjes dhe OBSH dhe UNICEF rekomandojnë *fillimin e hershëm të ushqyerjes me gji brenda 1 ore nga lindja, ushqyerjen ekskluzive me gji për 6 muajt e parë të jetës dhe futjen e ushqimeve plotësuese (të ngurta) të përshtatshme nga pikëpamja ushqyese dhe të sigurta në 6 muaj shoqëruar me vazhdimin e dhënies së gjirit deri në moshën 2 vjeç ose më shumë*. Në nivel global, rreth 44% e foshnjave 0-6 muajshe ushqehen ekskluzivisht me gji. Në Kosovë, bazuar në të dhënat e MICS të vitit 2020, vetëm 29% e foshnjave 0-6 muajsh marrin ushqyerje ekskluzive me gji dhe 1 në 3

fëmijë të moshës 6-23 muajsh marrin dietë minimale të pranueshme. Për referencë, në vitin 2019, 24% e fëmijëve të moshës 0-5 muajsh në Serbi ushqeheshin ekskluzivisht me gji.. Fatkeqësisht, statistika të tilla nuk janë në dispozicion për komunat individuale në Kosovë, por vlerësimi është se përqindja në komunat Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq korrespondon me gjetjet në mbarë Kosovën dhe Serbinë. Vlerësohet se më pak se 30% e nënave të foshnjave aplikojnë ushqyerje ekskluzive me gji në komunat e Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit.

Në vitin 2023 asnjë veprim pozitiv për promovimin e ushqyerjes me gji nuk është ndërmarrë nga asnjë institucion shëndetësor apo drejtori e shëndetit në komunat e synuara. Megjithatë, veprime të tilla rekomandohen fuqishëm dhe institucionet e kujdesit shëndetësor inkurajohen të angazhohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe UNICEF-in në aktivitete ndërgjegjësuese me nënat e foshnjave të porsalindura dhe fëmijëve për përfitimet afatgjata të ushqyerjes me gji për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Në lidhje me treguesit kryesorë të procesit, programi i mbështetjes ushqimore për familjet më të cenueshme me fëmijë lehtësohet nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet degëve lokale të Kryqit të Kuq dhe qendrave për mirëqenie sociale. Pakot ushqimore shpërndahen në baza mujore tek 680 familje në Mitrovicën e Veriut, 500 familje në Zveçan, 550 familje në Leposaviq dhe 376 familje në Zubin Potok. Numri i saktë i fëmijëve në këto familje është arritur të sigurohet por llogaritet se të paktën 1000 fëmijë përfitojnë nga kjo ndihmë.

4.1.2 Imunizimi

Imunizimi shpëton miliona jetë çdo vit, ndërkohë që vaksinat aktualisht në përdorim parandalojnë më shumë se 20 sëmundje kërcënuese për jetën. Imunizimi parandalon miliona vdekje çdo vit nga sëmundje si difteria, tetanosi, kolla e mirë, influenza (gripi) dhe fruthi. Pjesëmarrja e të gjithë fëmijëve në ciklet e rregullta të imunizimit është çelësi për t'i mbrojtur ata nga sëmundjet e parandalueshme dhe për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe jetëgjatësinë e fëmijëve. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme të shtrijme qasjen deri tek të gjithë fëmijët e moshave përkatëse dhe të ndërgjegjësojmë vazhdimisht prindërit për rëndësinë e cikleve të rregullta të imunizimit. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe shkollave është shumë i rëndësishëm në ndërgjegjësimin dhe zbatimin e cikleve të imunizimit.

Kalendari i vaksinimit i aplikuar nga institucionet shëndetësore rregullohet nga Instituti i Shëndetit Publik ⁴ dhe përfshin të gjitha vaksinat në moshën e caktuar të fëmijëve duke përfshirë BCG (kundër tuberkulozit), vaksinën kundër hepatitit B, vaksinën DTP (difteria, tetanosi, kollë e mirë), vakcina kundër poliomielitit, vakcina Hib dhe vakcina MMR (fruthi, shytat dhe rubeola).

Në Kosovë, bazuar në të dhënat e MICS, 73% e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh janë të imunizuar plotësisht, duke shënuar rënie krahasuar me 79% në vitin 2014. Bazuar në

⁴ <https://www.zjz.org.rs/wp-content/uploads/2023/08/Kalendar-vaksinacije-2023.docx>

informacionet nga mjekët përkatës, shkalla e imunizimit të foshnjave dhe fëmijëve në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq është më e lartë se mesatarja në Kosovë, pothuajse 100% për shumicën e vaksinave, me përjashtim të vetëm për vaksinën MMR, të cilën disa prindër priren ta shmangin në periudhën kur fëmijët janë 1 vjeç, pavarësisht se është parakusht i detyrueshëm për regjistrim në kopsht. Situata më e fundit me pjesëmarrje jashtëzakonisht të ulët për vaksinimin kundër virusit *papilloma humane* (HPV) ngre shqetësime serioze dhe bën thirrje për veprim për të luftuar kundër stereotipeve dhe dezinformatave kundër vaksinimit HPV, duke pasur parasysh efektin e tij shpëtues duke ofruar mbrojtje 100% për gratë kundër kancerit të qafës së mitres.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet se UNICEF-i ka realizuar një fushatë të mbështetur nga USAID-i për imunizimin e cila përfshin postime në billborde dhe sesione informuese, ndërsa UNICEF ka mbajtur edhe javën e vaksinimit dhe fushatën HALLO me fokus në ndërgjegjësimin për rëndësinë e vaksinave HPV dhe MMR. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme pas shkallës jashtëzakonisht të ulët të vaksinimit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve për të marrë vaksinën HPV, e cila ishte në dispozicion në Qendrën Shëndetësore në Mitrovicën e Veriut. Qëndrimet kundër vaksinimit nga ana e prindërve të fëmijëve në moshën e vaksinimit janë rritur pas pandemisë COVID-19. Kjo çoi në një numër shumë të ulët të fëmijëve të vaksinuar kundër HPV dhe shkallë të lartë të shmangies së MMR pasi foshnjat mbushin një vjeç.

4.1.3 Shëndeti i nënës, të porsalindurit dhe fëmijës

Ekziston një ndërlidhje ndërmjet ushqyerjes me gji dhe shëndetit të nënës bazuar në përvojën e OBSH/UNICEF-it në këtë fushë. Ka të gjetura se kohëzgjatja më e gjatë e ushqyerjes me gji gjithashtu kontribuon në shëndetin dhe mirëqenien e nënave duke reduktuar rrezikun e kancerit të vezoreve dhe gjirit dhe ndihmon distancimin e shtatzënanive. Ushqyerja ekskluzive me gji e foshnjave nën 6 muajsh ka një efekt hormonal tek nënat, gjë që shpesh shkakton mungesën e menstruacioneve. Kjo është një metodë e natyrshme (edhe pse jo e sigurt për dështimin) e kontrollit të lindjes e njohur si Metoda e Amenorrhoea e Laktacionit.

Për referencë, bazuar në të dhënat e MICS për Kosovën në vitin 2020, shkalla e vdekshmërisë neonatale ishte 11 vdekje për 1000 lindje të gjalla në periudhën menjëherë pas lindjes, shkalla e vdekshmërisë foshnjore ishte 15 vdekje për 1000 lindje të gjalla dhe shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç ishte 16 vdekje për 1000 lindje të gjalla. 100% e lindjeve janë kryer sipas standardeve të kualifikuara shëndetësore.

Bazuar në të dhënat nga njësitë pediatrike dhe gjinekologjike të Qendrës Shëndetësore në Mitrovicë, shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç, shkalla e vdekshmërisë së nënave (numri i nënave të vdekura nga problemet e lidhura me shtatzëninë për 100 lindje të gjalla) dhe shkalla e vdekshmërisë neonatale (numri i vdekjeve të të porsalindurve për 100 lindje) ishin 0 2023 në komunat e përfshira në studim.

Në total, 600 fëmijë janë shtruar në spital në vitin 2023 kryesisht për sëmundje të frymëmarrjes dhe të tretjes dhe 1 fëmijë është diagnostikuar me sëmundje të rrallë, që kërkon trajtim të specializuar.

4.1.4 Sistemi shëndetësor

Për vlerësimin e sistemit shëndetësor, mjeti vlerësues ka vendosur tregues strukturorë të kontekstualizuar rreth numrit të objekteve shëndetësore parësore për 10,000 banorë, numrin e objekteve të kujdesit shëndetësor dytësor për 10,000 banorë dhe numrin e objekteve të kujdesit shëndetësor terciar për 100,000 banorë.

Sipas vlerësimeve, komunat Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq kanë përafërsisht nga 14,000 deri në 17,000 banorë secila, ndërsa popullsia në Mitrovicën e Veriut shkon përtej 25,000 mijë banorëve. Në të katër komunat vërehen trende negative të migrimit, të cilat janë intensifikuar në dy vitet e fundit. Në vitet e fundit individë dhe familje të tëra e ndryshojnë gjithnjë e më shumë vendbanimin duke lëvizur drejt qendrave më të mëdha urbane në Serbi. Prandaj, shifrat për vlerësimet e popullsisë duhet të merren me rezervë. Këto të dhëna demografike të vlerësuara jepen vetëm për të mbështetur vlerësimin e numrit të objekteve shëndetësore për 10,000 banorë në komunat specifike më poshtë dhe nuk duhet të konsiderohen si të dhëna zyrtare.

Në Zveçan ekziston Qendra e Mjekësisë Familjare që gjendet në pjesën urbane të komunës dhe 6 ambulanca në fshatrat përreth. **Numri i objekteve të kujdesit parësor shëndetësor për 10,000 banorë është 4.66**, por duhet marrë me rezervë, duke qenë se disa ambulanca nuk kanë staf të përhershëm por vetëm mjekë dhe infermierë vizitues dhe gama e shërbimeve që ofrojnë është e kufizuar në krahasim me Qendrën e Mjekësisë Familjare. Nuk ka objekte të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar në territorin e komunës si dhe në komunat Zubin Potok dhe Leposaviq. Shërbimet e kujdesit sekondar shëndetësor shfrytëzohen në Qendrën Shëndetësore në Mitrovicën e Veriut e cila së fundi ka marrë statusin e qendrës klinike, e cila konsiderohet si ofruar kujdesit terciar shëndetësor, por ende pa kapacitete/ekspertizë të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të kujdesit shëndetësor terciar.

Në Zubin Potok është Qendra e Mjekësisë Familjare dhe 8 ambulanca në fshatrat përreth, prej tyre një në fshatin shqiptar Çabër. Numri i objekteve të kujdesit shëndetësor parësor për 10,000 banorë është 6.43. Në Leposaviq është 1 qendër e mjekësisë familjare dhe 9 ambulanca nëpër fshatra (prej tyre një në fshatin Bistricë me shumicë shqiptare). Bazuar në këto të dhëna, **numri i objekteve të kujdesit parësor shëndetësor për 10,000 banorë është 5.88**. Në Mitrovicën e Veriut, ekziston një qendër e mjekësisë familjare dhe një ambulancë fshati në fshatin e afërt Suvi Do që funksionon nën Ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë, ndërsa shqiptarët e Kosovës të lagjes së komunitetit të përzier Mikronaselje kanë qasje në ambulancën në këtë lagje, e cila funksionon nën spitalin e Mitrovicës së Jugut. Bazuar në informatat e ofruara, **numri i objekteve të kujdesit shëndetësor parësor për 10,000 banorë në Mitrovicën e Veriut është 1.2**. Njësoj si në Zveçan, vlerësimi për ambulancat e fshatrave

në Zubin Potok dhe Leposaviq duhet të merret me rezervë sa i përket gamës së shërbimeve të ofruara.

Të dhënat për numrin aktual të stafit në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq nuk ishin në dispozicion. Rrjedhimisht, nuk mund të bëhej zbërthimi i mëtejshëm i të dhënave bazuar në numrin e mjekëve, farmacistëve, stomatologëve dhe infermierëve për 1000 banorë në nivelin parësor si dhe peditërve, gjinekologëve, neonatologëve dhe infermierëve në nivelin e mesëm.

Në përgjithësi, qasja në shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor vlerësohet si e kënaqshme, megjithatë, qasja e mirë në shërbimet dytësore dhe terciare është mjaft e diskutueshme duke pasur parasysh se pacientët duhet të udhëtojnë ndërmjet 30 dhe 70 km në Mitrovicën e Veriut dhe në Serbi për pjesën më të madhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor terciar. Objektet shëndetësore nuk janë proaktive në aktivitetet e parandalimit dhe edukimit shëndetësor në komunitet. Shumica e veprimeve afirmative mbështeten nga organizata ndërkombëtare dhe OJQ.

4.1.5 Shëndeti fizik, mendor dhe riprodhues i adoleshentëve

Bazuar në vëzhgimet dhe informacionet nga institucionet e kujdesit shëndetësor, popullata adoleshente e synuar mbulohet me shërbime thelbësore të shëndetit mendor, fizik dhe riprodhues. Këto shërbime janë jashtëzakonisht të rëndësishme në fazën shumë të ndjeshme të zhvillimit psikofizik dhe emocional të fëmijës.

Në asnjërën nga katër komunat e vlerësuara nuk ka asnjë objekt këshillimi shëndetësor të dedikuar posaçërisht për adoleshentët dhe të rinjtë në moshën kritike të zhvillimit. Ata marrin informata kryesisht nga burimet online, miqtë, prindërit ose të afërmit. Ka psikologë shkollorë dhe pak psikologë privatë që ofrojnë shërbime këshilluese por nuk ka qasje proaktive nga njësitë përkatëse të institucioneve të kujdesit shëndetësor.

Kontrollet sistematike shëndetësore nuk kryhen rregullisht në klasat e larta të arsimit fillor dhe të mesëm. Institucionalizimi i shërbimeve të këshillimit për shëndetin riprodhues, edukimi për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe qasja në shërbimet e sigurta të abortit për vajzat në moshën adoleshente mbetet sfidë në të katër komunat.

Nuk ka qasje proaktive të akterëve të kujdesit shëndetësor në rritjen e ndërgjegjësimit tek adoleshentët për aspekte të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore të rëndësishme për këtë moshë të ndjeshme, veçanërisht për abuzimin me substancat, HIV, seksin e sigurt/planifikimin e familjes, shëndetin riprodhues, kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës dhe të tjera.

Nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e lindshmërisë tek adoleshentët por ka disa raste të bazuara në vëzhgime dhe informata nga mjekët. Për sa i përket diagnostikimit, ata kanë qasje në skanim CT, mamografi, pajisje me ultratinguj dhe shërbime të tjera.

Zhvillimi pozitiv i qasjes institucionale pro-aktive për parandalimin shëndetësor është thirrje publike për të gjitha gratë për ekzaminim parandalues/kontroll për kancerin e gjirit. Kjo praktikë është vërejtur së paku dy herë në vitin 2023 në ambientet e Shtëpisë së Shëndetit në Mitrovicën e Veriut. Informacioni për pjesëmarrjen e vajzave adoleshente për ekzaminim nuk është i disponueshëm.

4.2 Mjedisi dhe mbrojtja familjare

Fusha e mjedisit dhe mbrojtjes familjare përbëhet nga pesë (5) nënfusha duke përfshirë dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, fëmijët pa përkujdesje prindërore, drejtësinë për fëmijët, martesën e fëmijëve dhe praktika të tjera të dëmshme dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Disponueshmëria dhe saktësia e të dhënave për të gjitha nënfushat është pika e dobët e të gjithë sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Fëmijët nga komunat e synuara marrin disa shërbime në Serbi, më konkretisht vendosjen në familje strehuese ose në institucione përkujdesjeje.

4.2.1 Dhuna ndaj fëmijëve dhe grave

Një tregues strukturor në këtë fushë mat angazhimin e akterëve institucionalë për të mbështetur viktimat e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, që është *numri i strehimoreve për 50,000 banorë*. Në momentin e hartimit të këtij raporti, strehimorja e vetme për këtë qëllim që gjendet në Zubin Potok e cila u shërben të katër komunave, ka problem në funksionim për shkak të zhvillimeve të njohura politike në vitet 2022 dhe 2023. Në një situatë të tillë, gratë dhe fëmijët viktimat e dhunës në familje nuk kanë qasje në strehim dhe shërbime të tjera mbrojtëse të ofruara në këtë objekt si këshillim psikosocial, ndihmë juridike, furnizim me ushqime dhe veshje etj.

Informacioni mbi përqindjen e rasteve të procesuara në mënyrë efektive nga sistemi i drejtësisë penale (nga të gjitha rastet e raportuara) nuk ishte i mundur të merrej nga prokuroria, gjykatat dhe policia, por në bazë të vëzhgimeve, rrjedha e rasteve të tilla në sistemin e drejtësisë penale është e ngadalshme. Qasja në drejtësi për viktimat, ndjekja penale dhe dënimi i autorëve mbetet i dobët në këtë rajon si dhe në pjesë të tjera të Kosovës. Mosefektshmëria në procedimin e rasteve të tilla çon në mungesë të besimit në sistem dhe kufizim të mëtejshëm të viktimave për të raportuar rastet në polici. Vlerësimi është se më pak se 50 raste janë raportuar në polici dhe është një numër shumë i vogël i urdhrave të mbrojtjes të lëshuar nga gjykatat.

Në vitin 2023 nuk u raportuan raste të tilla dhune ndaj grave me pasoja fatale. Megjithatë, përvoja nga e kaluara nuk e përjashton një rezultat të tillë të sjelljes së dhunshme të autorëve të dhunës në familje në të ardhmen dhe veprimet parandaluese janë të një rëndësie të madhe. Nuk ka të dhëna të sistemuara pranë institucioneve shëndetësore për numrin e grave dhe fëmijëve të lënduar nga rastet e dhunës ndaj tyre, duke qenë se viktimat shpesh nuk raportojnë lëndimet dhe nuk kërkojnë ndihmë në spitale. Numri jashtëzakonisht i ulët i grave dhe fëmijëve, të mbijetuar të dhunës, kanë marrë shërbime mbështetëse (këshillim psikosocial, ndihmë juridike, fuqizim ekonomik).

Bazuar në të dhënat e MICS, në Kosovë 1 në 7 kujdestarë të fëmijëve të moshës 1 - 14 vjeç kanë raportuar se ndëshkimi fizik është i nevojshëm për rritjen apo edukimin e duhur të fëmijës. Përderisa 24 për qind e fëmijëve të moshës 1 - 14 vjeç disiplinohen vetëm me metoda jo të dhunshme, një pjesë e madhe e fëmijëve (72 për qind) raportohet se janë disiplinuar me dhunë (agresion psikologjik dhe/ose ndëshkim fizik). Për referencë, në Serbi, 45% e fëmijëve të moshës 1 deri në 14 vjeç përjetojnë disiplinim të dhunshëm në shtëpi.

Nuk ka të dhëna statistikore të disponueshme posaçërisht për komunat e synuara, por vlerësimi është se ato korrespondojnë me statistikat në mbarë Kosovën.

4.2.2 Fëmijët pa kujdes prindëror

Fëmijët pa kujdes prindëror janë veçanërisht të cenueshëm dhe jashtëzakonisht të ndjeshëm për t'u bërë viktimë të shfrytëzimit dhe abuzimit. Shërbimet ekzistuese të përkujdesjes në komunat e synuara mbështesin vendosjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore në përkujdesje familjare (farefisnore) ndërsa disa fëmijë në nevojë vendosen në familje kujdestare dhe përkujdesje rezidenciale në Serbi. Gjithsej, 18 fëmijë pa përkujdesje prindërore janë në kujdestari, prej tyre 9 me përkujdesje familjare (me të afërmit) në komunat e synuara, dhe këto familje janë të regjistruara dhe të mbështetura nga qendrat për mirëqenie sociale. Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë, secila komunë duhet të ketë së paku tri (3) familje kujdestare për fëmijë pa përkujdesje prindërore, të cilat vlerësohen, trajnohen dhe aprovohen sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në bazë të praktikës së deritanishme, përveç lidhjes farefisnore, fëmijët pa përkujdesje prindërore nga komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potok-ut dhe Leposaviqit janë dërguar për vendosje në familje kujdestare ose në institucione kujdestare në Serbi. Veprimi afirmativ i njohur deri më tani është bërë nga UNICEF-i i cili ka bërë vlerësimin për nevojat tona për familjet strehuese për komunën e Zubin Potokut, por nuk ka informacione për veprimet vijuese të iniciuara nga bartësit lokalë. Vlen gjithashtu të theksohet se janë organizuar një seri trajnimesh për familjet kujdestare dhe profesionistët përkatës të qendrave për mirëqenie sociale për ofrimin e kujdesit urgjent për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe përkujdesje alternative për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për referencë, në vitin 2023 Qendra për Mirëqenie Sociale në komunën e Graçanicës ka kërkuar mbështetje për themelimin e shërbimeve të përkujdesjes (farefisnore apo nga një familje tjetër) duke qenë se ka 18 fëmijë pa prindër në nevojë për përkujdesje alternative.

4.2.3 Drejtësia për fëmijët

Drejtësia për të miturit është një aspekt i rëndësishëm i mbrojtjes së fëmijëve dhe kërkon shërbime cilësore dhe efektive për fëmijët në kontakt me ligjin në situata të ndryshme. Këto shërbime nuk janë plotësisht të prezantuara dhe të qasshme për fëmijët në kontakt me ligjin në komunat e përfshira në këtë raport. Në Kosovë, kornizat ligjore dhe institucionale për drejtësinë për të mitur janë kryesisht të vendosura, ndërsa paraburgimi i të miturve përdoret

vetëm si mjet i fundit. Përmirësimi është i nevojshëm për qasjen në shërbime të specializuara për fëmijët nën përgjegjësi penale, duke përfshirë këshillimin, programet e parandalimit të delikucencës, arsimin, programet e aftësive profesionale dhe të jetës, dhe programet e rehabilitimit për shkelësit e mitur. Sfidat tjera përfshijnë kapacitetin e kufizuar dhe mungesën e koordinimit ndërmjet shërbimeve korrektuese dhe sprovuese dhe qendrave për punë sociale, të cilat duhet të avancohen për riintegrim social më efektiv dhe parandalimin e recidivizmit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, e cila mbulon komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, ka departamentin për të mitur dhe i trajton rastet që përfshijnë të mitur nga mosha 14 deri në 18 vjeç, bazuar në Kodin e Kosovës të Drejtësisë për të Mitur, duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Bazuar në statistikat e disponueshme të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe hulumtimin në zyrë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, punimeve akademike dhe burimeve të tjera, është gjetur përditësimi i fundit statistikor për vitin 2019, që tregon se 69 të mitur janë dënuar në Kosovë. Të miturit janë dënuar kryesisht për veprat penale të lëndimit të lehtë trupor dhe vjedhjes së rëndë. Mbi 50% e veprave të lëndimeve të lehta trupore kryhen pranë shkollave filllore dhe të mesme ndërsa vepra e vjedhjes së rëndë kryhet kryesisht për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe për blerje të lëndëve narkotike. Ndarja e ngjashme statistikore dhe shpjegimi i faktorëve shtytës vlerësohet për komunat e synuara, me shumë pak raste të njohura që të miturit nga Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani dërgohen në qendrën korrektuese të të miturve në Lipjan. Qendra e paraburgimit në Mitrovicë nuk ka asnjë objekt për të mitur. Informacioni mbi përqindjen e fëmijëve të dënuar që marrin dënim me burg dhe fëmijët e devijuar ose të dënuar që hyjnë në skemën e devijimit para dënimit nuk janë të disponueshme për komunat e përfshira, por vlerësimi është se nuk ka fare ose ka një numër jashtëzakonisht të ulët të rasteve të tilla. Nga ana tjetër, asnjë fëmijë i liruar nga paraburgimi nuk ka përkujdesje të mëtijshme, për shkak të bashkëpunimit të dobët ndërmjet shërbimit sprovues dhe qendrave për mirëqenie sociale.

Nuk është ndërmarrur asnjë veprim afirmativ vendor për parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në krim qoftë nga ndonjë rregull apo ligj, mbrojtje sociale apo institucion arsimor. Sa i përket mbështetjes së organizatave ndërkombëtare, UNICEF-i ndihmon institucionet e Kosovës në zbatimin e programeve të drejtësisë për të miturit në fushën e parandalimit të kriminalitetit të të miturve, alternativave të paraburgimit, përmirësimit të trajnimit profesional dhe të aftësive jetësore dhe riintegrimin e të rinjve në konflikt me ligjin në komunitetet e tyre.

4.2.4 Martesa e fëmijëve dhe praktika të tjera të dëmshme

Praktikat e martesave të hershme ende aplikohen në disa komunitete dhe pavarësisht se publikisht perceptohet si traditë, konsiderohet si një shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve. Ajo prek në mënyrë disproporcionale vajzat dhe djemtë, ndërsa në shumicën e rasteve vajzat

janë të mitura për martesë dhe shpesh përfshin dhunë ndaj grave dhe vajzave. Disa instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ofrojnë mbrojtje kundër martesës së fëmijëve duke përfshirë Konventën për Pëlqimin për Martesën, Mosha Minimale për Martesën dhe Regjistrimin e Martesave, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Platforma e Pekinit për Veprim 1995. Këto instrumente ndërkombëtare mbulojnë heqjen e zakoneve dhe traditave të dëmshme, dhunën ndaj vajzave, pëlqimin për martesë, moshën e martesës, regjistrimin e martesës dhe lirinë për të zgjedhur bashkëshortin. Edhe martesat e detyruar është e ndaluar dhe e dënueshme me Kodin Penal të Kosovës.

Në Kosovë sot martesat e fëmijëve janë relativisht të rralla, por ajo vazhdon të jetë praktikë në disa komunitete dhe/ose grupe etnike. Më të cenuarit veçanërisht, por jo ekskluzivisht, janë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, por kjo ndodh edhe me komunitetet e tjera në shkallë më të vogël. Nuk ka të dhëna të disponueshme për numrin e fëmijëve të mitur të martuar në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, por supozohet se pothuajse asnjë ose shumë pak raste janë vërejtur në baza vjetore. Gjithashtu, për shkak të normave tradicionale shoqërore familjet përdoren të mos deklarojnë publikisht raste të tilla.

4.2.5 Shfrytëzimi i fëmijëve

Shfrytëzimi i fëmijëve manifestohet në forma të ndryshme, duke filluar nga puna e paligjshme/e detyruar, trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe servituti, fëmijët që kërkojnë lëmshë e të tjera. Anketa e UNICEF MICS zbuloi se rreth 5.3 për qind e fëmijëve në Kosovë dhe 7 për qind e fëmijëve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian janë të përfshirë në punën e fëmijëve. Ata janë të përfshirë në bujqësi, pylltari, miniera, ndërtim, punë në rrugë, duke përfshirë shitjen e gjërave të vogla, transportin manual të mallrave dhe kërkim lëmoshe, pastrimin e plehrave në vendgrumbullime, kërkim i detyruar i lëmshës, shfrytëzimin seksual tregtar dhe përdorimin në aktivitete të paligjshme. Këto dy të fundit ndonjëherë janë rezultat i trafikimit të qenieve njerëzore.

Sa i përket intensitetit të punës, fëmijët e përfshirë në punë në Kosovë kalojnë mesatarisht 10.3 orë në javë duke punuar. Situata është më e keqe për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët punojnë 18.6 orë në javë. Intensiteti kohor i punës së fëmijëve dhe përfshirja në punët e shtëpisë përkeqësohet kur fëmijët rriten, ndërsa vajzat kanë shumë më shumë gjasa të angazhohen në punët e shtëpisë sesa djemtë dhe për orë më të gjata. Disa fëmijë janë të përfshirë në punë të rrezikshme që rrezikojnë shëndetin, sigurinë dhe zhvillimin e tyre intelektual, më saktësisht 2.7 për qind e fëmijëve janë të ekspozuar ndaj kushteve të rrezikshme në vendin e punës në përgjithësi në Kosovë.

Bazuar në të dhënat e ONP/UNICEF-it për statusin e aktivitetit të fëmijëve për komunat në rajonin e Mitrovicës (të ndara sipas gjinisë, rajonit dhe vendbanimit, për grupmoshën 5-14 vjeç), 0.2% të fëmijëve janë që vetëm punojnë, 82.4% e fëmijëve që vetëm shkollohen, 12.4% e fëmijëve që punojnë dhe shkollohen, 3.3% nuk janë të përfshirë në asnjërën nga aktivitetet, 12.6% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve që punojnë, 96.6% e numrit të

përgjithshëm të fëmijëve në shkollë dhe 3.4% jashtë shkollës. Në grupmoshën 15-17 vjeç, 0,9% e fëmijëve janë vetëm duke punuar, 78,6% e fëmijëve janë vetëm në shkollë, 16,8% e fëmijëve janë duke punuar dhe duke u shkolluar, 3,7% e fëmijëve nuk janë as në punë e as në shkollë, me 17,7% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve që punojnë, 95.4% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve në shkollë dhe 4.6% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve jashtë shkollës.

Bazuar në vëzhgimet dhe krahasimet e rezultateve ndërmjet të gjithë Kosovës dhe rajonit të Mitrovicës, është nxjerrë përfundimi se këto praktika aplikohen në shkallë relativisht më të vogël në komunat e përfshira në këtë raport Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potok-u, me përqindje të fëmijëve të përfshirë në punën ose punë të detyruar pak më të ulët se në nivel të Kosovës. Megjithatë, statistika të tilla nuk merren nga institucionet përkatëse në fushën e mbrojtjes sociale dhe duhet të avokohet me to për futjen e metodave përkatëse të mbledhjes së të dhënave për këtë aspekt të rëndësishëm.

Me zhvillimin e shpejtë teknologjik në dekadat e fundit, shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet është vazhdimisht në rritje. Lidhja celulare, zgjerimi i mblueshmërisë së internetit dhe zhvillimi i zgjidhjeve të transmetimit me pagesë gjatë përdorimit, të cilat ofrojnë një shkallë të lartë anonimiteti për shikuesin, po e çojnë më tej trendin e transmetimit të drejtpërdrejtë komercial të abuzimit seksual të fëmijëve. Prandaj, një nga masat që duhet të ndërmerret është ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe prindërve për edukimin kritik mediatik dhe rreziqet e shfrytëzimit seksual që ekzistojnë në internet.

Nuk ka të dhëna për fëmijët viktime të trafikimit me qenie njerëzore dhe shfrytëzimit seksual për komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Bazuar në informacionet e disponueshme, asnjë rast i tillë nuk është raportuar në polici apo prokurori në vitin 2023.

4.3 Arsimi

Qasja në arsim cilësor është më e rëndësishmja për zhvillimin e përgjithshëm psikologjik dhe fizik të fëmijës, njëjtë i rëndësishëm në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin në fëmijërinë e hershme, arsimin parashkollor përgatitor, fillor, të mesëm dhe terciar. Të gjitha komunat e përfshira ofrojnë shërbime arsimore duke filluar nga çerdhet, kopshtet dhe shkollat fillore deri te shkollat e mesme dhe arsimin e lartë, duke zbatuar kurrikulat e zhvilluara nga Ministria e Arsimit e Serbisë, me përjashtim të shkollave në fshatrat me shumicë shqiptare dhe vendbanimet në të katër komunat që aplikojnë kurrikulën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Në fushën e arsimit, vlerësimi është bërë për katër nënfusha duke përfshirë sistemin arsimor, qasjen dhe pjesëmarrjen në arsim, aftësitë mësimore dhe cilësore, dhe kohën e lirë dhe kulturën.

4.3.1 Sistemi i arsimit

Të gjitha shkollat në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok i plotësojnë standardet bazë sa i përket infrastrukturës, pajisjeve, numrit të mësimitdhënësve të kualifikuar dhe stafit mbështetës, si dhe respektimit të kërkesave programore të ministrive përkatëse. Qasja dhe cilësia e arsimit është joproporcionale për fëmijët në zonat rurale të komunave të përfshira në krahasim me vendbanimet urbane.

Bazuar në raportin e mbledhjes së të dhënave të Domovik, në vitin 2022, numri i përgjithshëm i fëmijëve që vijnë në arsimin fillor në Leposaviq ishte 1215, ndërsa numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme ishte 367. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara me qasje në arsimin parashkollor ishte 13 (2.8% e të gjithë fëmijëve të regjistruar). Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në programet e arsimit fillor ishte 12, ndërsa në arsimin e mesëm janë regjistruar 8 fëmijë me aftësi të kufizuara (2.1% e të gjithë fëmijëve të regjistruar). Në Leposaviq numri i mësimdhënësve ⁵ për 100 nxënës në arsimin fillor është 13.27, ndërsa në arsimin e mesëm 23.27 mësimdhënës për 100 nxënës. Në Zubin Potok, bazuar në raportin e mbledhjes së të dhënave të publikuar nga Domovik për vitin 2021, i cili përmban të dhëna për numrin e fëmijëve në nivele të ndryshme arsimore, duke përfshirë 95 fëmijë në çerdhe (53 djem, 42 vajza), 149 në kopsht (85 djem, 64 vajza), 67 fëmijë në programin përgatitor parashkollor (30 djem dhe 37 vajza), 316 fëmijë në klasat e shkollës fillore (ndarja gjinore ishte e njohur për 2 nga 3 shkolla -133 djem dhe 133 vajza), 342 fëmijë në klasat e shkollës e mesme të ulët(166 djem dhe 176 vajza), dhe 217 fëmijë në shkollën e mesme të lartë (119 djem dhe 98 vajza). Në shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Zubin Potokut ka 16.91 mësimdhënës për 100 fëmijë.

Bazuar në raportin e mbledhjes së të dhënave të Domovik-it në vitin 2022, në komunën e Zveçanit janë të regjistruar 185 fëmijë në arsimin parashkollor të fëmijërisë së hershme (83 vajza dhe 102 djem) ndërsa numri i fëmijëve në programin përgatitor parashkollor ishte 80 (44 vajza dhe 36 djem). Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin fillor ishte 621 (269 djem dhe 352 vajza). Numri i fëmijëve që vijnë në shkollën e mesme ishte 250, ndërsa 3 fëmijë me aftësi të kufizuara kishin qasje në arsimin fillor (2 djem dhe 1 vajzë) dhe 1 në arsimin e mesëm. Në komunën e Zveçanit, në shkollat fillore janë 13.31 mësimdhënës për 100 fëmijë, dhe 19.46 mësimdhënës për 100 nxënës në shkollat e mesme.

4.3.2 Qasja dhe pjesëmarrja në shkollim

Qasja universale dhe përfundimi i arsimit fillor dhe të mesëm duhet të shtrihet me të njëjtën qasje ndaj programeve të arsimit të hershëm dhe parashkollor. Vlerësohet se deri në 50% e fëmijëve në komunat e synuara nuk kanë qasje në programet e arsimit të hershëm për shkak të mungesës së hapësirës në kopshtet e fëmijëve në zonat urbane dhe mosekzistencës së kopshteve në zonat rurale. Për referencë, bazuar në të dhënat e MICS 2020 për Kosovën, vetëm 15% e fëmijëve të moshës 35-69 muajsh janë duke ndjekur ndonjë program të fëmijërisë së hershme (8% e fëmijëve që jetojnë në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane). Raporti neto i frekuentimit në arsimin fillor është 96%, i mesëm i ulët 94% dhe i mesëm i lartë 87%, ndërsa për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë raporti është 84% për shkollën fillore, 64% për shkollën e mesme të ulët dhe 31% për shkollën e mesëm të lartë. 3,645 nxënës me aftësi të kufizuara janë regjistruar në shkolla të rregullta bazuar në të dhënat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (2018/19). Vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë arsim dhe shërbime sociale bazuar në të dhënat e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF). Bazuar në MICS Kosovë 2020, 8% e fëmijëve raportuan vështirësi funksionale në të paktën një fushë.

⁵ Të dhënat rreth numrit të mësimdhënësve ofruar nga OSCE për komunat Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, dhe mund të ndryshojnë për 10%, duke marrë parasysh se numrat e tanishëm nuk janë në dispozicion.

Bazuar në publikimin e Domovik-it për shkollimin në fëmijërinë e hershme⁶, ka pabarazi dhe parregullsi të konsiderueshme në qasjen në shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme ndërmjet fëmijëve që jetojnë në zonat urbane dhe rurale në komunitetet e përfshirura këtu vlerësim, duke përfshirë Mitrovicën e Veriut, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Leposaviqin. Fëmijët në komunitetet që jetojnë në fshatra të largëta nuk kanë qasje në programet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe rrjedhimisht nuk kanë fillim të barabartë me fëmijët që jetojnë në vendbanimet urbane. Fëmijët në fshatrat e largëta duhet të udhëtojnë për në shkollat fillore dhe të mesme të cilat ndodhen në fshatra më të mëdha ose në pjesë urbane të komunave. Shkalla e frekuentimit të shkollës është e lartë si për nivelin fillor ashtu edhe për atë të mesëm (95% e sipër). Shkalla e përfundimit të arsimit fillor dhe të mesëm është gjithashtu e lartë (100% shkolla fillore, 98% shkolla e mesme).

4.3.3 Aftësitë dhe cilësitë e të nxëniet

Kjo nënfushë është plotësisht referente për rezultatet e procesit arsimor, duke reflektuar cilësinë e mësimdhënies dhe efektivitetin dhe efikasitetin e metodave të mësimdhënies të aplikuara në nivele të ndryshme arsimore. Rezultatet e testeve më të fundit të OECD PISA, të kryera në vitin 2022 dhe të publikuara në dhjetor 2023 tregojnë një renditje shumë të ulët të fëmijëve të Kosovës, të cilët janë të tretët nga fundi, nga 87 vende pjesëmarrëse. Nga ana tjetër, fëmijët në Serbi u renditën në vendin e 40-të për aftësitë e leximit dhe në vendin e 42-të në matematikë. Nuk dihet për rezultatin e fëmijëve në komunitetet e përfshira si dhe nëse ata kanë qenë të përfshirë në mostrën e fëmijëve të testuar qoftë për Kosovën apo Serbinë.

MICS 2020 tregoi se 41% e fëmijëve në Kosovë kanë nivel themelor të shkathtësive të shkrim-leximit dhe 42% të shkathtësive numerike, ndërsa këto proporcione të fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë janë përkatësisht 18% dhe 13%. Papunësia e lartë në mesin e të diplomuarve në arsimin e lartë është regjistruar në hulumtimin e BE-së në vitin 2018, me 26,7% të papunë në tremujorin e tretë të 2017, që mund të lidhet me cilësinë e pamjaftueshme të arsimit në të gjitha nivelet.

Në komunitetet e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, nuk ka të dhëna të sistemuara që mund të përdoren për vlerësimin e përqindjes së fëmijëve të moshës 24-59 muajsh, të cilët janë zhvillim në rrugën e duhur për shëndetin, mësimin dhe mirëqenien psikosociale. Numri i saktë i fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë jashtë shkollës nuk dihet, ndërkohë që prezantimi efektiv i arsimit gjithëpërfshirës mbetet sfida për të gjitha shkollat.

4.3.4 Koha e lirë dhe kultura

Në shumicën e shkollave dhe objekteve parashkollore fëmijët kanë qasje në aktivitete jashtëshkollore duke përfshirë ekskursione, folklor, muzikë dhe seksione teatrale, gara sportive, punëtori dhe aktivitete kërkimore, megjithatë shumica e mësuesve dhe edukatorëve të intervistuar theksuan nevojën për aktivitete shitesë dhe më bashkëkohore si dhe hapësirë fizike shitesë për të akomoduar punëtori dhe pajisje. Ekzistojnë shoqata lokale sportive në të katër komunitetet, duke përfshirë klubet e futbollit, basketbollit, volejbollit dhe

⁶ <https://domovik.org/wp-content/uploads/2022/12/Early-childhood-education-equality-starts-at-the-community-level.pdf>

hendbollit që ofrojnë mundësi për djem dhe vajza dhe shumica e tyre kanë trajnime për grupmosha të ndryshme.

Shkolla fillore dhe e mesme e muzikës funksionojnë në Mitrovicën e Veriut si dhe një shkollë e muzikës rock, ndërsa grupet folklorike amatore ekzistojnë në të katër komunat. Të gjitha komunat e synuara kanë qendra kulturore të cilat organizojnë shfaqje teatrale, ekspozita të arteve pamore dhe kinema. Ekziston edhe muzeu lokal në Mitrovicën e Veriut dhe Fakulteti i Arteve me seksione për artet pamore, dramë dhe muzikë. Një galeri private në Mitrovicën e Veriut ka seksione për grupmosha të ndryshme të fëmijëve në pikturë, skulpturë dhe instalime. Në komunat e përfshira organizohen disa festivale muzikore në zhanre të ndryshme, duke përfshirë festivalin e xhazit dhe bluz në Zveçan/Mitrovicën e Veriut, festivalet e rock-ut në Mitrovicën e Veriut dhe Leposaviq, festivalin e muzikës popullore në Lesak (komuna e Leposaviqit), festivalin e eko-artit në Mitrovicën e Veriut dhe të tjerë. Megjithatë, ka pabarazi të konsiderueshme në qasjen në programet kulturore për fëmijët që banojnë në zonat rurale dhe fëmijët që jetojnë në qendrat urbane.

Përqindja e saktë e fëmijëve që ndjekin disa programe/trajnime kulturore, aktivitete jashtëshkollore dhe programe sportive nuk është e disponueshme, por vlerësimi i përgjithshëm është se të gjithë fëmijët kanë qasje në aktivitetet kulturore dhe ato të kohës së lirë, ndërsa cilësia e tyre korrespondon me nevojat e fëmijëve, burimet dhe kapacitetet në komunat e përfshira.

4.4 Pjesëmarrja dhe të drejtat civile

Në përputhje me KDF, të drejtat dhe liritë civile të fëmijëve përfshijnë të drejtën për identitet, respektimin e pikëpamjeve të fëmijës, lirinë e shprehjes, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si dhe lirinë e shoqërimit dhe tubimit paqësor. Në këtë aspekt, pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren parasysh si në familje dhe shoqëri, ashtu edhe në të gjitha nismat e planifikimit të politikave lokale që kanë të bëjnë me fëmijët. Në këtë fushë, kuadri i monitorimit përfshin katër nënfusha duke përfshirë regjistrimin e lindjes dhe identitetin, pjesëmarrjen e fëmijëve, të drejtat civile dhe politike, dhe informacionin, internetin dhe mbrojtjen e privatësisë.

4.4.1 Regjistrimi i lindjes dhe identiteti

Regjistrimi i lindjes është njohja e parë e fëmijëve para ligjit, i cili mbron të drejtat e tyre dhe siguron ndalimin e çdo shkeljeje të këtyre të drejtave. Anketa e fundit e MICS në Kosovë ka treguar se 98% e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare në Kosovë janë të regjistruar, përqindje e njëjtë e vajzave dhe djemve, ndërsa ndryshimi del në lidhje me nivelin e arsimit të nënës dhe nivelin e të ardhurave.

Bazuar në të dhënat nga spitali dhe të katër komunat, të gjithë fëmijët e porsalindur janë të regjistruar në regjistrin civil, i cili drejtohet nga sistemi serb. Problem mbetet për regjistrin civil të Kosovës duke qenë se institucionet shëndetësore funksionojnë në kuadër të sistemit serb dhe nuk kanë bashkëpunim të drejtpërdrejtë me regjistrin civil të Kosovës. Kjo është çështje praktike e cila kërkon më shumë përpjekje nga të gjitha anët nëse fëmijët e këtyre prindërve duhet të kenë qasje në të gjitha të drejtat dhe privilegjet në sistemin e mbrojtjes

sociale të Kosovës. Informacioni se sa fëmijë nuk janë të regjistruar në sistemin e gjendjes civile të Kosovës mund të merret me shqyrtimin krahasues të librave të gjendjes civile në dy sistemet, gjë që nuk është e mundur në situatën aktuale. Nuk ka veprime afirmative për promovimin e regjistrimit të lindjeve të zbatuara nga autoritetet në asnjërin sistem.

4.4.2 Pjesëmarrja e fëmijëve

Nuk ka mekanizma efektive të reagimit që kanë cak fëmijët sa u përket shërbimeve të ofruara nga institucionet e pushtetit vendor. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, i cili është paraparë të jetë mekanizëm i tillë sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, ende nuk është krijuar në secilën komunë. Asnjë institucion arsimor, i kujdesit dhe mbrojtjes sociale dhe shëndetësor nuk ka procedura ankimore miqësore për fëmijët dhe lehtësisht të qasshme të mandatuara me ligj. Disa institucione që mund të shërbenin si mekanizëm i tillë ekzistojnë para zhvillimeve më të fundit politike me njësitë komunale për të drejtat e njeriut, megjithatë nuk u zbatua asnjë qasje proaktive në inicimin e mekanizmave të adresimit dhe reagimit miqësor ndaj fëmijëve.

Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme kanë themeluar parlamentet e shkollave dhe këshillat e prindërve, por fëmijët nuk janë të përfaqësuar në bordet e shkollave. Ndikimi real i fëmijëve në vendimmarrje nuk është i matshëm, por vëzhgimet tregojnë se mekanizmat e vendosur janë më tepër formal se sa ndikues në nivelin për të avancuar situatën e të drejtave të fëmijëve. Asnjë nxënës nuk merr pjesë në punën e organeve drejtuese të shkollave dhe këshillave të prindërve. Nuk ka asamble për fëmijë në asnjë nga komunat e përfshira dhe themelimi dhe funksionalizimi i tyre mund të jetë një kontribut i rëndësishëm drejt rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse.

Shumica e institucioneve të drejtësisë po aplikojnë qasje miqësore ndaj fëmijëve me fëmijët që janë në kontakt me ligjin në procedurat penale dhe ato familjare. Megjithatë, nuk dihet se në çfarë mase fëmijët marrin pjesë në procedurat ligjore për çështje të lidhura me familjen dhe birësimin.

4.4.3 Liritë dhe politikat civile

Angazhimi për të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në vendimet që prekin ata është i përfshirë në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe legjislacionin në Kosovë. Bazuar në nenin 12 të KDF-së, pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren parasysh në përputhje me moshën dhe kapacitetin e tyre dhe në interesin më të mirë të fëmijës. Megjithatë, autoritetet lokale nuk angazhohen në përfshirjen e fëmijëve kur miratojnë dokumente politikash dhe nuk organizojnë asnjë konsultim me fëmijët në kuadër të zhvillimit të politikave dhe vendimmarrjes. Kjo qasje është promovuar në masë të madhe në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit nga organizatat ndërkombëtare UNICEF dhe Save the Children, në bashkëpunim me OJQ-të vendore, por ende nuk është miratuar në kulturën institucionale lokale.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja qytetare e fëmijëve mbështetet në mënyrë thelbësore nga organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Aktivitetet e tyre me të rinjtë dhe adoleshentët promovojnë edukimin për qytetari aktive së bashku me përvetësimin e aftësive për jetën. Qasja përputhet gjithmonë me nevojat e të

rinjve me procesin arsimor, ndërkohë që aktivitetet kanë ndikim në zhvillimin personal të pjesëmarrësve dhe në komunitetet më të gjera, duke i mësuar përfituesit se si angazhimi i tyre mund të sjell ndryshime në kontekstin lokal. Podiumi, UPSHIFT, Avokimi për ndryshim, PONDER - Programi Kritik i Edukimit Mediatik dhe Generation Unlimited janë programet më të fundit të zbatuara me fëmijët në shkollat fillore dhe të mesme si koncepte të arsimit⁷ joformal.

Sa i përket lirisë së tubimit, fëmijët dhe adoleshentët në të katër komunat e synuara kanë mundësi për vullnetarizëm dhe aktivitete të tjera me OJQ-të lokale Domovik, Santa Marija dhe të tjera. Fëmijët kanë mundësi të ushtrjnë të drejtën e lirisë së shprehjes përmes artit dhe përdorimit të rrjeteve sociale, mjeteve dhe medimeve në rrjet dhe jashtë rrjetit.

4.4.4 Të dhënat, interneti dhe mbrojtja e privatësisë

Kosova është ndër vendet që ka mbulueshmërinë më të lartë me internet në Evropë, me më shumë se 90% të familjeve me qasje në internet me shtrirje të gjerë me shpejtësi të lartë. Në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, interneti ofrohet përmes operatorëve të telefonisë mobile, operatorëve të TV kabllor dhe operatorëve të internetit pa tela. Cilësia e sinjalit ndryshon në zonat urbane dhe rurale dhe mund të jetë e dobët ose të ketë ndërhyrje në zonat malore për shkak të konfigurimit të terrenit. Kjo krijoi pabarazi në qasjen në shkollim për fëmijët në zonat rurale për klasat përmes internetit të aplikuara gjatë pandemisë. Fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët përdorin kryesisht internetin përmes telefonave inteligjentë.

Operatorët e televizionit kabllor ofrojnë qasje në programet televizive në të katër komunat, por kryesisht në zonat urbane, lagje dhe fshatra më të mëdha, ndërsa në fshatrat e largëta banorët përdorin marrës dixhitalë ose marrin sinjale tokësore me antenat e shtëpisë/kutitë e konfigurimit. Ka shumë programe në gjuhën serbe dhe shqipe në dispozicion, duke përfshirë përmbajtjen edukative dhe argëtuese për fëmijë dhe adoleshent.

Për sa i përket mbrojtjes së privatësisë, nuk ka trajnim të institucionalizuar për mbrojtjen e privatësisë në domenin online, dhe edukim kritik mediatik për fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët janë të ekspozuar ndaj rrezikut të shkeljes së të drejtës së privatësisë dhe mund të bëhen lehtësisht viktima të abuzimit. Të paktën një rast i pornografisë hakmarrëse me fëmijë është regjistruar nga policia, ku autori është dërguar në institucionin korrektues.

4.5 Varfëria

Në fushën e varfërisë, kuadri i monitorimit fokusohet në tre nënfusha duke përfshirë sistemin e mbrojtjes sociale, varfërinë e fëmijëve dhe privimin material si dhe ujin dhe kushtet sanitare. Qasja në të dhëna për dy nënfushat e para ishte e kufizuar për shkak të mungesës së të gjitha burimeve të të dhënave në qendrat për mirëqenie sociale dhe departamentet

⁷ https://domovik.org/wp-content/uploads/2023/05/Policy-paper_2022.pdf

komunale që merren me mbrojtjen sociale. Ndryshe nga institucionet shëndetësore dhe arsimore të cilat funksionojnë vetëm nën kujdesin e ministrive përkatëse serbe, qendrat për mirëqenie sociale funksionojnë si në sistemin e mbrojtjes sociale të Kosovës ashtu edhe në atë të Serbisë, dhe nuk ka dallim të qartë ndërmjet shërbimeve të ofruara nga secili dhe përfituesit e tyre përkatës.

4.5.1 Sistemi i mbrojtjes sociale

Sistemet e mbrojtjes sociale ndihmojnë individët dhe familjet, veçanërisht ata të varfër dhe të cenueshëm për të kapërcyer krizat dhe për të mbështetur shëndetin dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Bazuar në të dhënat e raportit të Bankës Botërore të vitit 2019, më shumë se 26 mijë familje kanë marrë ndihmë sociale në vitin 2017 dhe supozohet se ky numër është rritur pas krizës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 dhe inflacionit të rritur me ngritjen e çmimeve të energjisë.

Sa i përket komunave të përfshira në këtë vlerësim, bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)⁸, 217 familje (523 individë) në Leposaviq kanë qenë përfituese të ndihmës sociale në dhjetor 2018, në Zveçan 301 familje me 699 individë dhe në Zubin Potok 434 familje me 983 individë. Numri i saktë i fëmijëve në këto familje nuk është i disponueshëm me grupet e të dhënave të ASK-së. Sa i përket ndihmës sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara, në dhjetor 2018, në Leposaviq ishin 16 përfitues, në Zubin Potok 13 dhe në Zveçan 11.

Të dhënat e mësipërme korrespondojnë kryesisht me situatën aktuale, me më pak se 5% të variacionit të vlerësuar bazuar në hulumtimet dhe vëzhgimet në zyrë. Kontrolli i pjesshëm i të dhënave mund të bëhet në bazë të raportit të mbledhjes së të dhënave të Domovik-it të publikuar në vitin 2021, i cili zbuloi se në vitin 2020, në Zveçan, në familjet përfituese të skemës së ndihmës sociale ishin 62 fëmijë të moshës 0-14 vjeç. Në Zubin Potok kanë qenë 819 fëmijë përfitues të ndihmës për fëmijë në zonat rurale, 342 familje përfituese të skemës së ndihmës sociale dhe 16 familje të fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitues të ndihmës dhe përkujdesjes për një person tjetër. Në Leposaviq ishin 166 shfrytëzues të asistencës së dedikuar për fëmijët e moshës 0-5 të prindërve të papunë, 50 përfitues në kategorinë fëmijë të prindërve të vetëm dhe 13 familje me fëmijë me aftësi të kufizuara përfitues të ndihmës dhe përkujdesjes për një person tjetër.

4.5.2 Varfëria e fëmijëve dhe privimi material

Bazuar në të dhënat e disponueshme nga raporti i UNICEF-it⁹ për vitin 2022, 23% e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, ndërsa 7% e fëmijëve jetojnë në varfëri ekstreme. Shkalla e papunësisë mes 15-24-vjeçarëve është 49 për qind, ndërsa në të njëjtën grupmoshë, 29.8 për qind janë “As në Arsim, Punësim apo Trajnim (NEET)” që do të thotë se një në tre të rinj e gjen veten pa mundësi për të studiuar ose punuar (UNICEF, Generation Unlimited, 2022).¹⁰ Nuk kishte të dhëna të disponueshme për përqindjen e fëmijëve në

⁸ <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/>

⁹ <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/reports/annual-report-2022#>

¹⁰ <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo-generation-unlimited#>

familjet me të ardhura të ulëta ose përqindjen e fëmijëve që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët të punës dhe familjet pa punë, ose përqindjen e fëmijëve (të moshës 0-17 vjeç) që jetojnë nën varfëri shumëdimensionale në komunat e përfshira në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Megjithatë, bazuar në vlerësime, përqindja e fëmijëve që jetojnë në varfëri relative dhe absolute korrespondojnë me të dhënat në mbarë Kosovën.

4.5.3 Uji, kushtet sanitare dhe higjiena

Kushtet e mira të jetesës dhe mjedisi i shëndetshëm janë kritike për mirëqenien e të gjithë fëmijëve dhe adoleshentëve. Bazuar në të dhënat e MICS, në Kosovë, deri në 25% e fëmijëve nën 5 vjeç jetojnë në familjet më të varfra dhe vetëm 7 për qind e grave dhe 12 për qind e burrave të moshës 15 - 49 vjeç janë të mbuluar me sigurim shëndetësor. Përderisa shumica e shtëpive familjare në Kosovë kanë shërbimet bazë të ujit të pijshëm dhe shërbimet bazë sanitare (rreth 90 përqind), rreth 23 përqind e popullsisë konsumon ujë të kontaminuar me *Escherichia coli*.

Në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, pothuajse të gjithë banorët janë të mbuluar me sigurime shëndetësore publike nga Serbia. Banorët që jetojnë kryesisht në pjesët urbane të komunave të Mitrovicës së Veriut (më shumë se 95% e amvisërive), Zveçanit dhe Zubin Potok (më pak se 50% e familjeve) janë të kyçur në sistemin rajonal të furnizimit me ujë. Më pak se 50% e banorëve të Leposaviqit (familjet që jetojnë në pjesën urbane të komunës) janë të kyçur në ujësjellësin lokal. Cilësia e ujit të shfrytëzuar nga banorët përmes sistemit të ujësjellësit testohet rregullisht nga Instituti për Shëndet Publik. Cilësia e ujit të pijshëm vlerësohet si shumë e mirë.

Zonat rurale në të gjitha komunat mbështeten në burimet e ujit pranë fshatrave me ujëmbledhës dhe puse të ndërtuara, prej nga tubacionet e ujit sjellin ujin për familjet individuale ose të grupuara. Nuk ka të dhëna të disponueshme për testimin e cilësisë së ujit të pijshëm në fshatrat përreth të komunave të përfshira.

Më shumë se 80% e familjeve në Mitrovicën e Veriut janë të lidhura me sistemin e kanalizimit, por sistemi i largimit të ujërave të zeza nuk është plotësisht funksional, gjë që rrezikon seriozisht lumin Ibër. Më pak se 50% e familjeve në komunën e Zveçanit janë të kyçura në sistemin e kanalizimit, ndërsa shtëpitë e fshatrave kryesisht përdorin gropën septike për kanalizim. Përmasat e njëjta të lidhjeve me kanalizimet janë vlerësuar për komunën e Leposaviqit, ku qendra e qytetit dhe dy vendbanimet më të mëdha Soçanica dhe Lesak janë të lidhura me sistemin sanitar. Vetëm amvisëritë në pjesën urbane të vendbanimit janë të kyçura në sistemin sanitar në komunën e Zubin Potokut, ndërsa në shumicën e fshatrave janë në përdorim gropat septike. Nuk ka sistem për largimin e ujërave të zeza dhe ujërat e zeza nga sistemi i kanalizimit derdhen direkt në lumin Ibër.

5. Çështjet ndërsektoriale

5.1 Shkollimi në fëmijërinë e hershme

Qasja në shkollimin në fëmijërinë e hershme mbetet një nga sfidat kryesore në të katër komunat për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme për të akomoduar të gjithë fëmijët në nevojë në zonat urbane dhe mungesës së kapaciteteve për shkollim të hershëm në shumicën e zonave rurale. Përçindja e ulët e fëmijëve me qasje në kopshte në fshatra ngre shqetësime serioze për fillimin e pabarabartë të arsimit të rregullt mes fëmijëve në zonat urbane dhe rurale. Mos vijimi i arsimit në fëmijërinë e hershme ka ndikim kritik në rezultatet e të nxënit të këtyre fëmijëve në nivelet e mëtejshme të arsimit dhe arritjen e potencialit të tyre të plotë. Të gjitha komunat duhet të shumëfishojnë përpjekjet dhe investimet në infrastrukturën e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të punësojnë burime njerëzore shtesë, për të siguruar që çdo fëmijë të ketë qasje në kopshte dhe programe cilësore të shkollimit të hershëm.

5.2 Gjinia

Vajzat në të katër komunat kanë qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit, shërbimet e mbrojtjes sociale dhe shumicën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe të mesëm. Megjithatë, më shumë vëmendje dhe mbështetje duhet t'i kushtohet qasjes së përmirësuar në shërbimet e këshillimit për shëndetin riprodhues të vajzave adoleshente. Qasja në metodat e përshtatshme kontraceptive është kritike për të parandaluar shtatzëninë në adoleshencë dhe pasojat e saj. Gratë dhe vajzat janë më të cenueshme dhe nuk mbrohen në mënyrë efektive kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në të katër komunat. Ato janë gjithashtu të përfshira në një masë më të madhe në punën e fëmijëve krahasuar me djemtë dhe më të cenueshme për t'u bërë viktimë të shfrytëzimit seksual komercial, pornografisë hakmarrëse dhe abuzimit seksual në internet.

5.3 Aftësia e kufizuar

Fëmijët me aftësi të kufizuara në të katër komunat vazhdojnë të përballen me diskriminim në qasje në shkollimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, ndërkohë që familjeve të tyre u mungon mbështetja e gjithanshme nga shoqëria dhe institucionet. Futja e shërbimeve të asistentit personal dhe asistentit pedagogjik për fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës është vetëm në fazën fillestare të zbatimit për shkak të mbështetjes së organizatave ndërkombëtare, megjithatë institucionalizimi i tyre ende nuk është arritur me komunat, ndërsa numri i asistentëve është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjithë fëmijët në nevojë. Ndihma sociale për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara është e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të këtyre fëmijëve. Shumë fëmijë me aftësi të kufizuara ndjekin shkollën për arsim special dhe marrin mbështetje nga OJQ-të, megjithatë mungon qasja sistematike dhe strategjike për integrimin e tyre efektiv në arsim, punësim dhe shoqëri.

5.4 Adoleshentët

Fëmijët kanë nevojë për mbështetje më gjithëpërfshirëse në moshën e ndjeshme të adoleshencës për të kapërcyer më mirë sfidat e tranzicionit në të rritur dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre fizik, mendor dhe riprodhues. Kontrollat e rregullta sistematike shëndetësore në klasat e larta të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe shërbimet e këshillimit për shëndetin fizik dhe mendor, duhet të futen dhe të jenë të qasshme për adoleshentët në të katër komunat. Përveç përmirësimit të cilësisë së arsimit të mesëm, programet e arsimit joformal duhet të ofrohen si mundësi plotësuese për mësimin dhe zhvillimin e aftësive.

5.5 Mjedi dhe ndryshimet klimatike

Fëmijët dhe adoleshentët në të katër komunat tregojnë mirëkuptim për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe veprimit klimatik. Në anketën¹¹ e kryer nga OJQ Domovik në vitin 2023 me fëmijët dhe të rinjtë nga komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Laposaviqit, Zubin Potok-ut, Graçanicës dhe Prishtinës, më shumë se 45% e të anketuarve konsiderojnë se ndryshimi klimatik është kërcënim serioz dhe 41% janë deklaruar të gatshëm të pranojnë ndryshimin e stilit të jetës personale për të lehtësuar ndikimin negativ në mjedis. Më shumë se 70% e të anketuarve konsiderojnë se zhvillimi ekonomik duhet të përafrohet me mbrojtjen e mjedisit.

Deponia rajonale për deponimin e mbeturinave për komunat në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës është ndërtuar, por ende nuk është funksionalizuar dhe nuk është në përdorim. Përderisa nuk ka një iniciativë të madhe nga akterët institucionale, në të katër komunat ka OJQ të cilat avokojnë për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja. Disa prej tyre organizojnë aksione pastrimi dhe aktivitete ndërgjegjësuere me publikun, ku shpesh marrin pjesë fëmijët dhe adoleshentët.

5.6 Rreziqet dhe veprimet humanitare

Në janar të vitit 2023, rajoni i Mitrovicës u prek rëndë nga vërshimet, dhe shumë shtëpi në Mitrovicën e Veriut dhe Jugut, Zveçan, Zubin Potok dhe Laposaviq u përmytën rëndë. Shumë familje me fëmijë u evakuuan dhe u zhvendosën përkohësisht nga shtëpitë dhe banesat e tyre. Ndihma është ofruar nga qeveria, komunat, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Megjithatë, përkundër përfshirjes së akterëve të shumtë, shumë familjeve nuk iu ofrua asistencë adekuate për rinovimin e dëmeve të shtëpive të tyre dhe objekteve të gjenerimit të të ardhurave dhe tokës bujqësore.

¹¹ <https://domovik.org/publikacie/>

6. Përfundime

Vlerësimet e para të të drejtave të fëmijëve në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potok-ut testuan me sukses kornizën e zhvilluar nga Domovik vitin e kaluar. Sipas pritshmërive, kjo ka konfirmuar rëndësinë e mbledhjes sistematike të të dhënave në të gjitha fushat e treguara në mjetin e përdorur, duke përfshirë shëndetin dhe të ushqyerit, mjedisin dhe mbrojtjen e familjes, arsimin, pjesëmarrjen dhe të drejtat civile dhe varfërinë. Në këtë drejtim, një nga veprimet prioritare duhet të jetë krijimi i njësive të menaxhimit të të dhënave dhe njohurive me institucionet përkatëse duke përfshirë qendrat e mjekësisë familjare dhe njësinë pediatrike të spitalit, drejtoritë komunale të shëndetësisë, arsimin dhe mbrojtjes sociale, qendrat për mirëqenie sociale dhe shkollat. Ky vlerësim dhe instrumenti i kornizës së monitorimit mund të shërbejnë si udhëzues për analiza më gjithëpërfshirëse të situatës sektoriale dhe vendosjen e bazave për vlerësimet e ardhshme të të drejtave të fëmijëve.

Në përputhje me vlerësimin bazë, çdo institucion i rëndësishëm për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve duhet të përcaktojë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fëmijët dhe t'i integrojë ato në planifikimet dhe programin e tyre, duke përfshirë gjithmonë fëmijët dhe duke integruar pikëpamjet dhe propozimet e tyre në masën maksimale të mundshme. Rritja e ndërgjegjësimit për imunizimin, mbështetja e ushqyerjes së përshtatshme, rritja e investimeve në shkollimin në fëmijërinë e hershme dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi janë fusha prioritare për përmirësim dhe ndërhyrje. Ekziston nevoja për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional përmes qasjes ndërsektoriale për zbatimin e programit dhe ofrimit të shërbimeve të integruara për fëmijët.

